

**KOMBET E
BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen
Penale të Personave Përgjegjës për
Shkelje të Rënda të së Drejtës
Humanitare Ndërkombëtare të Kryera
në Territorin e ish-Jugosllavisë prej
Vitet 1991

Lënda Nr. IT-04-84-R77.4

Data: 21 nëntor 2008

Originali: anglisht

NË DHOMËN GJYQËSORE I

Para: Gjykatësit Alphons Orië, Kryegjykatës
Gjykatëses Christine van den Wyngaert
Gjykatësit Bakone Justice Moloto

Sekretari: Z. Hans Holthuis

Urdhëresë e datës: 21 nëntor 2008

PROKURORI

kundër

ASTRIT HARAQISË

dhe

BAJRUSH MORINËS

PUBLIK

**URDHËRESË PËR THIRRJEN E ASTRIT HARAQISË DHE TË BAJRUSH
MORINËS NGA LIRIMI I PËRKOHSHËM**

Zyrës së Prokurorit:

Z. Dan Saxon

**Misionit të Administratës së
Përkohshme të Kombeve të Bashkuar
në Kosovë**

Avokatëve të të Akuzuarve

Z. Karim A. A. Khan për Astrit Haraqinë
Z. Jens Dieckman për Bajrush Morinën

Qeverisë së Mbretërisë së Holandës

DHOMA GJYQËSORE I (“Dhoma Gjyqësore”) e Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë prej vitit 1991 (“Tribunali”);

DUKE MARRË SHËNIM Vendimin në Lidhje me Kërkesën e Mbrojtjes për Lirimin e Përkohshëm të të Akuzuarit Astrit Haraqija, dorëzuar publikisht më 15 shtator 2008, dhe Vendimin në Lidhje me Kërkesën e Mbrojtjes për Lirimin e Përkohshëm të të Akuzuarit Bajrush Morina, dorëzuar publikisht më 15 shtator 2008, në të cilët Dhoma Gjyqësore vendosi kushtet për lirimin e përkohshëm të Astrit Haraqisë dhe të Bajrush Morinës, dhe urdhëroi që Astrit Haraqija dhe Bajrush Morina “t’i përmbahen përpikmërisht çfarëdo Urdhërese tjetër të Dhomës Gjyqësore që mund të ndryshojë kushtet e lirit të tyre të përkohshëm ose ta përfundojë atë” dhe “të kthehen në Njësinë e Paraburgimit të Kombeve të Bashkuara (“UNDU”) në Hagë në një kohë që do të përcaktohet prej Dhomës Gjyqësore;”¹

DUKE MARRË PARASYSH se vendimi në këtë çështje parashikohet të shpallet më 17 dhjetor 2008;²

BAZUAR në Nenin 29 të Statutit të Tribunalit dhe në Rregullat 54 dhe 65 të Rregullores së Procedurës dhe Provave të Tribunalit;

CAKTON që:

1. Astrit Haraqija dhe Bajrush Morina të kthehen në UNDU në Hagë, më 15 dhjetor 2008;
2. Misioni i Administratës të Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) të emërojë një zyrtar i cili do të shoqërojë Astrit Haraqinë dhe Bajrush Morinën nga vendbanimet e tyre në Kosovë për në aeroportin e Prishtinës më 15 dhjetor 2008;
3. UNMIK-u të njoftojë Dhomën Gjyqësore dhe Sekretarinë e Tribunalit, sa më shpejt që të jetë e mundur, për emrin e zyrtarit të caktuar;

¹ Vendim në lidhje me kërkesën e Mbrojtjes për lirimin e përkohshëm të të Akuzuarit Astrit Haraqija, 15 shtator 2008, para. 13; Vendim në lidhje me kërkesën e Mbrojtjes për lirimin e përkohshëm të të Akuzuarit Bajrush Morina, 15 shtator 2008, para. 13.

4. Astrit Haraqija dhe Bajrush Morina të lirohen, në aeroportin e Prishtinës, në kujdes të zyrtarit të sigurimit të emëruar nga Sekretari i Tribunalit, i cili do të shoqërojë Astrit Haraqinë dhe Bajrush Morinën gjatë pjesës tjetër të udhëtimit të tyre për në aeroportin e Schiphol-it;

5. Astrit Haraqija dhe Bajrush Morina të lirohen, në aeroportin e Schiphol-it, në kujdes të autoriteteve holandeze dhe të transportohen në UNDU, më 15 dhjetor 2008;

6. UNMIK-u të marrë përsipër sigurinë personale të Astrit Haraqisë dhe të Bajrush Morinës deri sa të dorëzohen në aeroportin e Prishtinës në kujdes të zyrtarit të sigurimit të emëruar nga Sekretari i Tribunalit më 15 dhjetor 2008;

7. Sekretari i Tribunalit të marrë përsipër sigurinë personale të Astrit Haraqisë dhe të Bajrush Morinës deri sa të dorëzohen në aeroportin e Schiphol-it në kujdes të autoriteteve holandeze më 15 dhjetor 2008;

8. Qeveria e Mbretërisë së Holandës të marrë përsipër transportimin, me roje, të Astrit Haraqisë dhe të Bajrush Morinës nga aeroporti i Schiphol-it në UNDU;

UDHËZON që:

1. Sekretari i Tribunalit të këshillohet me Ministrinë e Drejtësisë së Holandës lidhur me masat praktike të kthimit të Astrit Haraqisë dhe të Bajrush Morinës në UNDU;

2. UNMIK-u, Qeveria e Mbretërisë së Holandës dhe Sekretaria e Tribunalit të mbajnë lidhje me njëri tjetrin për të lehtësuar kthimin e rregullt të Astrit Haraqisë dhe të Bajrush Morinës në UNDU;

KËRKON që autoritetet e tërë shteteve nëpërmjet territorit të të cilëve mund të udhëtojnë Astrit Haraqija dhe të Bajrush Morina:

1. të mbajnë Astrit Haraqinë dhe Bajrush Morinën në mbikqyrje gjatë kohës së tranzitit; dhe

² Urdhër për caktimin e datës së shpalljes së gjykimit, 21 nëntor 2008, f. 2.

2. të arrestojnë dhe të burgosin Astrit Haraqinë dhe të Bajrush Morinën gjatë kthimit për në UNDU në Hage, nëse përpiqen të arratisen.

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

nënshkruar në origjinal/
Gjykatësi Alphons Orié
Kryegjykatës

Sot, me datën 21 nëntor 2008
Në Hagë
Holandë

[Vula e Tribunalit]